



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1644/2 Prot.

Vlorë më, 28.10.2021

VENDIM
Nr. 38, datë 28.10.2021

PËR
ÇELJEN E PROCEDURAVE DHE AFATEVE TË APLIKIMIT PËR ANËTARË NË
BORDIN E ADMINISTRIMIT TË UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORË,
PËRFAQËSUES TË UNIVERSITETIT

Në mbështetje të nenit 3, pika 4, të nenit 48 pikës 1 dhe 2 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të nenit 19, pika 1, gërma II, të nenit 24, pika 1, gërma a, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë Senati Akademik në mbledhjen e datës 28.10.2021,

VENDOSI:

1. Të shpallë procedurën dhe afatet për përzgjedhejn e 3 (tre) anëtarëve të Bordit të Administrimit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, përfaqësues të Universitetit.
2. Kjo procedurë të respektojë fazat dhe afatet e mëposhtme:
 - a) Afati i dorëzimit të dokumenteve për aplikim si kandidat për anëtar në Bordin e Administrimit në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, përfaqësues të universitetit do të jetë nga data 01.11.2021 deri më datë 09.11.2021.
 - b) Afati i dorëzimit të dokumenteve nga njësitë bazë për të bërë propozimet për anëtar në Bordin e Administrimit në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë përfaqësues të universitetit do të jetë nga data 01.11.2021 deri më datë 09.11.2021.
 - c) Sekretari i SA tërheq me procesverbal nga Sektori i Protokoll Arkivës dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët për anëtar të Bordit të Administrimit dhe ia paraqet SA në mbledhjen e tij të radhës.
 - d) Votimi në Senat i kandidaturave bëhet në datë 16.11.2021, në mbledhjen e tij të radhës.
 - e) Emrat e 3 (tre) anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të institucionit, përcillen në MAS.
3. Individët dorëzojnë kërkesën për kandidaturën e tyre me shkrim pranë Sektorit të Protokoll Arkivës e cila duhet të përmbajë të dhëna individuale si: emri, mbiemri, grada shkencore/ titulli akademik (nëse ka) dhe njësia kryesore nga vjen. Edhe kandidaturat



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

e propozuara nga njësitë bazë paraqesin të dhënat e mësipërme dhe kërkesa e tyre dorëzohet nga Përgjegjësi i Departamentit në Sektorin e Protokoll Arkivës.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi: Drejtuesit e njësive kryesore, Drejtuesit e njësive bazë, Drejtorja e Komunikimit dhe e Burimeve Njerëzore.
5. Vendimi protokollohet dhe bëhen njoftimet përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

NËNKRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. As. Xhiliola AGARAJ

